

Dr. Tony B. Watlington, Ed. D.
Superintendent

28 Qershor, 2022

Përshëndetje Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Unë po ju shkruaj për t'ju përditësuar për një pjesë kyçe të prioriteteve të mia 100-ditore. Përmirësimi i rezultateve të nxënësve dhe arritja e Objektivave dhe Qëllimeve të Bordit, të tilla që Drejtoria Arsimore e Filadelfias (SDP) të pozicionohet si një nga drejtoritë urbane me përmirësim më të shpejtë të vendit, kërkon veprime të qëllimshme dhe strategjike. Përveç kryerjes së seancave të gjera dëgjimi dhe mësimi, unë do të angazhoj një Ekip Tranzicioni për të më ndihmuar në vlerësimin dhe rritjen e kapaciteteve të Drejtorisë sonë Arsimore.

Një Ekip Tranzicioni është një qasje e organizuar për të ndihmuar një superintendent që vjen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të shpejtë për të mësuar rreth drejtorisë. Ai përbëhet nga një grup drejtuesish lokalë dhe ekspertë kombëtarë që mbledhen në nën-komitete për të adresuar vështirësitë specifike arsimore, për të aplikuar kërkimet më të fundit dhe praktikën më të mira, për të ofruar rekomandime afatshkurtra dhe afatgjata, për të ndihmuar drejtorinë të bëjë përparim në ato fusha.

Krijimi i Ekipeve të Tranzicionit është duke u zhvilluar në mënyrë aktive, i bashkëdrejtuar nga Dr. Shawn Joseph (ish-drejtor i vitit në Met Life në Maryland, ish-superintendent i shkollës në Tenesi dhe Delaware dhe bashkëdrejtor i Shoqatës Amerikane të Administratorëve të Shkollës (AASA)/ Akademia e Superintendit Urban të Universitetit Howard) dhe Dr. Betty Morgan (një superintendent e dalluar, ish-Superintendent Kombëtare e Vitit dhe Këshilltare Kryesor Arsimor i Aleancës së Premtimit të Amerikës). Së bashku, ata kanë udhëhequr gjashtë procese tranzicioni në vitet e fundit në drejtori të mëdha shkollore urbane.

Ekipi do të bashkëkryesohet nga dy drejtues të respektuar të Filadelfias dhe do të përbëhet nga pesë nënkomitete që janë të përafuara me fushat që përshkrova në [Prioritetet e mia 100-ditore](#). Çdo nën-komiteti do të bashkëdrejtohet nga një drejtues i distriktit shkollor dhe një drejtues arsimor jo-SDP me ekspertizë në atë fushë specifike. Së bashku ata do ta sigurojnë atë objektiv, të paanshëm jepen rekomandime. Anëtarët e komitetit do të përfshijnë personelin e Drejtorisë Arsimore, si dhe drejtues të arsimit, të qytetit, të biznesit jofitimprurës . Puna e tyre do të zgjasë disa muaj, ku secili komitet do të gjenerojë gjetje dhe rekomandime që do të ndahen në një raport gjithëpërfshirës në Bordin e Arsimit këtë vjeshtë dhe do të informojnë zhvillimin e një plani strategjik në pranverën e vitit 2023.

Pres me padurim të fillojmë zyrtarisht Ekipin e Tranzicionin tonë, duke ndarë më shumë informacione me ju në javët e ardhshme. Deri atëherë, ju lutemi kujdesuni dhe jini të sigurt këtë verë.

Në partneritet për fëmijët,

A handwritten signature in blue ink that reads "Tony B. Watlington, Sr." in a cursive script.

Dr. Tony B. Watlington
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias